



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Nr. 898/1 Prot.

Tiranë, më 25.09/2017

**Lënda:** Dërgohen mendime për projektligjin “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

**Drejtuar :** **Z.ULSI MANJA**  
**KRYETAR**  
**KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN**  
**PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUN**  
**KUVENDI I SHQIPËRISË**

**TIRANË**

**I nderuar z. Manja,**

Në përgjigje të shkresës Tuaj nr.2135 Prot., datë 18.09.2017 me lëndë “*Dërgohet për mendim projektligji “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u njoh me projektligjin<sup>1</sup> dhe relacionin shprehet sa më poshtë:

Neni 7, ku parashikohet “*ndalimi i diskriminimit*”, propozojmë të përafrohet përkufizimi me parashikimet që bën Ligji nr. 10221 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” si vijon:

Pika 1 të riformulohet si më poshtë:

*“Ndalohet diskriminimi që sjell si pasojë çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, “për shkak të përkatësisë në pakicë kombëtare”, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Pika 3, e nenit 7, të riformulohet si më poshtë:

<sup>1</sup> Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë edhe pjesë e Grupit të Punës “*Për hartimin e Projektligjit për Pakicat Kombëtare*”, i cili është Udhëhequr nga Ministria e Punëve të Jashtme.

*“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përkatësisë në “pakicë kombëtare”, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim.”*

Neni 12 pika 7 të shtohet: *“Dispozitat e këtij neni do të zbatohet pa cënur mësimin e gjuhës shqipe dhe parimin e mosdiskriminimit.”*

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,**

